



# PRITJA PËR DREJTËSI

TETOR 2016, PRISHTINË



|||||

# PRITJA PËR DREJTËSI

**RAPORT I SHËRBIMIT TË KDI PËR KËSHILLA LIGJORE PËR  
VIKTIMAT, DËSHMITARËT DHE DENONCUESIT E KORRUPSIONIT**

TETOR 2016, PRISHTINË

|||||



COPYRIGHT © 2016.Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45  
10000, Prishtinë, Kosovë.  
Tel.: +381 (0)38 248 038  
E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)  
Web: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Autor: Florent Spahija

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Gjermanisë. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

# PËRMBAJTJA

<b>SHKURTESAT .....</b>	<b>8</b>
<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....</b>	<b>8</b>
<b>PËR RAPORTIN .....</b>	<b>9</b>
<b>SISTEMI I GJYKATAVE .....</b>	<b>9</b>
<b>ADMINISTRIMI I LËNDËVE NGA GJYKATAT .....</b>	<b>9</b>
ÇFARË (S)ËSHTË BËRË PËR TË REDUKTUAR NUMRIN E LËNDËVE? .....	11
PARASHKRIMI SI “MASË” PËR REDUKTIMIN E LËNDËVE .....	14
<b>RASTET E RAPORTUARA NË KDI .....</b>	<b>15</b>
RASTI NN1.....	15
RASTI NN2.....	16
RASTI NN3.....	16
RASTI NN4.....	17
<b>KU QËNDROJNË KËTO RASTE SOT?.....</b>	<b>18</b>
<b>GJETJET KRYESORE .....</b>	<b>18</b>
<b>REKOMANDIME .....</b>	<b>19</b>



# SHKURTESAT

- KDI** → Instituti Demokratik i Kosovës
- AKGjK** → Këshilli Gjyqësor i Kosovës
- GjThPr** → Gjykata Themelore në Prishtinë
- ALAC** → Shërbimi për Avokim dhe Këshilla Ligjore
- AKP** → Agjencia Kosovare e Pronës
- AKM** → Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
- EULEX** → Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimit të Ligjit në Kosovë



# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në vitin 2015, shërbimi për këshilla ligjore për viktimat, dëshmitarët dhe denoncuesit e korrupsionit në kuadër të KDI-së ka publikuar raportin *Korrupsioni: Cili është tregimi yt?*, ku janë përmbledhur statistikave kryesore të këtij shërbimi. Shumica e rasteve të raportuara ndërlidheshin me sektorin e gjyqësorit, përkatësisht vonesat e gjykatave në procedimin e rasteve të palëve. Edhe gjatë vitit 2016 në KDI kanë vazhduar të denoncohen raste që lidhen me gjykatat dhe me mos efikasitetin e tyre.

Ky raport mëton të gjejë shkaqet e mosefikasitetit të gjykatave në kryerjen e lëndëve. Përmes statistikave të siguruar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, KDI ka analizuar statusin e lëndëve të papërfunduara deri në fund të vitit 2015. Në raport, po ashtu, tregohet gjendja e lëndëve të pa kryera ndër vite. Theks i veçantë u është dhënë rasteve konkrete që janë raportuar në KDI përmes numrit pa pagesë 0800 77777.

Hulumtimi ka gjetur se në gjykatat tona vazhdojnë të mbesin lëndë të pa gjykuara që nga viti 1999. Për katër rastet e raportuara në Shërbimin për këshilla ligjore të KDI-së, çështja e zvarritjes së procesve gjyqësore lidhet me vonesat në caktimin e seancave, numrin e madh të lëndëve që gjykatat i kanë në menaxhim gjatë një viti dhe rrjedhimisht me mungesën e gjykatësve dhe stafit mbështetës për gjykatës për t'u marrë me këto lëndë. Ekzistojnë edhe raste tjera të raportuara në KDI që mbështesin zvarritjen e lëndëve, por palët e përfshira në to nuk kanë dhënë leje për publikimin e tyre me frikën se nëse publikohen, gjykatësit do të hakmerren dhe do të prolongojnë edhe më tej caktimin e lëndëve të tyre. Vonasat në zgjidhjen e lëndëve i vërteton edhe vetë KGJK në një raport të saj ku për përbarimin (ekzekutimin) e një lënde gjykatave tona i janë dashur 650 deri në 1500 ditë. Mosgjykimi lëndëve në kohë të arsyeshme paraqet shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, parim ky i pranuar edhe me ligjet dhe me Kushtetutën e Kosovës.

Duke u bazuar në këto gjetje, KDI rekomandon KGJK-në që të adresojnë këto mungesa në afatin sa më të shkurtër, përkatësisht të rrisin numrin e gjykatësve dhe të stafit mbështetës për gjykatës (zyrtarëve ligjor, këshilltarëve ligjor, bashkëpunëtorëve profesional dhe praktikantëve). KDI kërkon nga KGJK të adresojë nevojën e krijimit të një sistemi funksional të procedimit të rasteve bazuar këta fak-

torë: specializimi në çështje (psh: krim i organizuar, çështje ekonomike, çështjet e pronës, luftë kundër korrupsionit etj.), vjetërsia, vëllimi i punës dhe konfliktet potenciale të interesit. KGJK-së i rekomandohet që të përmirësojë sistemin funksional të menaxhimit të lëndëve, raportimit dhe qasjes në statistika.



Hulumtimi ka gjetur se në gjykatat tona vazhdojnë të mbesin lëndë të pa gjykuara që nga viti 1999. Për katër rastet e raportuara në Shërbimin për këshilla ligjore të KDI-së, çështja e zvarritjes së procesve gjyqësore lidhet me vonesat në caktimin e seancave, numrin e madh të lëndëve që gjykatat i kanë në menaxhim gjatë një viti dhe rrjedhimisht me mungesën e gjykatësve dhe stafit mbështetës për gjykatës për t'u marrë me këto lëndë.



Vonasat në zgjidhjen e lëndëve i vërteton edhe vetë KGJK në një raport të saj ku për përbarimin (ekzekutimin) e një lënde gjykatave tona i janë dashur

## 650 deri në 1500 ditë



# PËR RAPORTIN

Ngritja e vetëdijes së qytetarëve për t'raportuar dhe adresuar korrupsionin mbetet një ndër synimet e KDI përkatësisht Shërbimi për Avokim dhe Këshilla Ligjore (ALAC). Përmes ofrimit të këshilla ligjore pa pagesë, denoncuesit, dëshmitarët dhe viktimat e korrupsionit mbështeten dhe fuqizohen për të kërkuar drejtësi dhe llogaridhënie për rastet e tyre e me këtë të bëhen akterë aktivë në luftën kundër-korrupsion.

Raporti është një përmbledhje e rasteve të raportuara në ALAC, të cilat reflektojnë shkalljet e të drejtave elementare të qytetarëve të Kosovës nga sistemi i drejtësisë. Për të kuptuar më drejtë këtë problematikë raporti ilustron edhe sistemin e shkallshmërisë së gjykatave dhe statistikën rreth administrimit të lëndëve gjyqësore.

## SISTEMI I GJYKATAVE

Gjykatat që nga fillimi i vitit 2013 kanë ndryshuar në emërtime dhe shkallshmëri. Sistemi aktual i gjykatave në Kosovë përbëhet nga Gjykatat Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme.<sup>1</sup> Gjykatat themelore janë gjykata të shkallës së parë të themeluara në shtatë komunat më të mëdha: Prishtinë, Gjilan, Prizren, Gjakovë, Pejë, Ferizaj dhe Mitrovicë.<sup>2</sup> Gjykata e Apelit është gjykatë e shkallës së dytë e themeluar në Prishtinë, përgjegjëse me shqyrtimin e ankesave ndaj vendimeve dhe konflikteve të juridiksionit të Gjykatave Themelore.<sup>3</sup> Të gjitha gjykatat themelore kanë tri departamente që trajtojnë (1) krimet e rënda, (2) çështjet e përgjithshme dhe (3) të miturit, me përjashtim të Gjykatës Themelore në Prishtinë e cila ka edhe dy departamente të tjera: (1) çështjet ekonomike, (2) rastet administrative, që janë kompetente për gjithë Kosovën.<sup>4</sup>

Gjykata Supreme është gjykata më e lartë, përgjegjëse për të gjykuar kërkesat dhe revizionet kundër urdhrave të

formës së prerë të gjykatave, për të përcaktuar parimet dhe mjetet juridike që kërkojnë aplikim unik, dhe për rastet nën fushëveprimin e Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP) dhe Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM).<sup>5</sup> Në vitin 2016, Kosova u pajtua për një mandat të ri për EULEX-in, ndërsa më herët në vitin 2014 dhe për krijimin e një gjykate të përkohshme speciale për krime lufte.

Para 2013, sistemi i gjykatave kishte këtë strukturë: Gjykata Komonale, Gjykatat e Qarkut dhe Gjykata Supreme. Në kuadër të këtij sistemi bënë pjesë edhe Gjykata për Kundërvajtje, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë dhe Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme.

## ADMINISTRIMI I LËNDËVE NGA GJYKATAT

Sipas raportit të KGJK-së, në të gjitha nivelet e gjykatave janë të punësuar gjithsej 343 gjykatës, në ndihmë të të cilëve është i angazhuar një staf prej 1,441 personave, ku hyjnë bashkëpunëtorët profesionalë, sekretarët juridikë, punëtorët e zyrave për menaxhimin e lëndëve, arkivistët, postierët, zëdhënësit, punëtorët ndihmës dhe administratorët.<sup>6</sup> Nga 343 gjykatës, Gjykata Supreme e Kosovës ka 14 gjykatës, Dhoma e Posaçme ka 13 gjykatës, Gjykata e Apelit 38 gjykatës, ndërsa gjykatat themelore kanë 278 gjykatës.

Mbi supet e 343 gjykatësve, në mbarë vendin gjatë periudhës një vjeçare, bie gjykimi i më shumë se 350 mijë lëndëve të natyrave të ndryshme si: penale, civile, administrative dhe kundërvajtëse. Barra më me madhe e shqyrtimit të lëndëve gjatë një viti bie mbi gjykatësit e niveleve të gjykatave themelore.<sup>7</sup> Arsye për këtë numër të madh lëndëve është pasi gjykata themelore është shkalla e parë. Normalisht këto gjykata kanë edhe numrin më të madh të gjykatësve dhe personelit mbështetës.

1 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Nr. 79. Ligji Nr. 03/L-199. Ligji për Gjykatat, Neni 4. 24 gusht 2010, f. 2.

2 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Nr. 79. Ligji Nr. 03/L-199. Ligji për Gjykatat, Neni 9. 24 gusht 2010, f. 3.


3 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Nr. 79. Ligji Nr. 03/L-199. Ligji për Gjykatat, Neni 18. 24 gusht 2010, f. 7.

4 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Nr. 79. Ligji Nr. 03/L-199. Ligji për Gjykatat, Neni 12. 24 gusht 2010, f. 5.

5 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Nr. 79. Ligji Nr. 03/L-199. Ligji për Gjykatat, Neni 22. 24 gusht 2010, f. 9.

6 Shih: <http://www.gjyqesori-rks.org/sq/kjc/report/list/1> faqe 3

7 Ibid.



Sipas raportit të statistikave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës,<sup>8</sup> në fund të vitit 2014 në të gjitha nivelet e gjykatave kishin mbetur pa u gjykuar 430,923 lëndë. Këto lëndë u bartën në vitin 2015 si lëndë të pazgjidhura, ndërsa këtij kontigjenti iu shtuan edhe 406,864 lëndë të reja të paraqitura në 2015. Rrjedhimisht, gjykatat në nivel të vendit kishin në punë, ose detyrim për t'i përfunduar 837,787 lëndë.<sup>9</sup> Deri në fund të 2015-tës gjykatat tona kanë arritur t'i zgjidhin 396,844 lëndë, ndërsa në 2016 kanë bartur 440,943 lëndë të vjetra e të pazgjidhura të të gjitha natyrave gjyqësore. Këtu nuk janë të përfshira rastet e reja që vazhdojnë të paraqiten në 2016. Një numër kaq i madh i rasteve të pazgjidhura ka bërë që gjykatat të duken joefikase në sy të publikut. Megjithatë gjykatat vazhdojnë të punojnë në zgjidhjen e rasteve. Vetëm gjatë vitit 2015 një gjykatës në gjykatën themelore ka zgjidhur mesatarisht 29 raste për një muaj. Nëse e zbërthejmë këtë numër për ditë pune atëherë i bie se një gjykatës gjykon, apo përfundon 1,32 raste në një ditë pune. Përkundër këtij volumi të punëve nga gjykatësit, qytetarëve të Kosovës vazhdojnë të mos iu përfundohen lëndët në kohë duke shkelur nenin 6, paragrafi 1<sup>10</sup> të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut,

Gjykatat e Kosovës vazhdojnë të strehojnë lëndë të pazgjidhura të cilat janë deponuar para 10 vitesh, por për të cilat ende nuk është caktuar asnjë seancë për gjykim, madje as nuk është ndërmarrë ndonjë veprim procedural për fillimin e tyre.

i cili flet për gjykim në kohë të arsyeshme, parim ky i pranuar edhe me ligjet dhe me kushtetutën e Kosovës.

Gjykatat e Kosovës vazhdojnë të strehojnë lëndë të pazgjidhura të cilat janë deponuar para 10 vitesh, por për të cilat ende nuk është caktuar asnjë seancë për gjykim, madje as nuk është ndërmarrë ndonjë veprim procedural për fillimin e tyre.

8 Ibid.

9 KDI ka vërejtur se tabela e përgjithshme e lëndëve e paraqitur në raportin zyrtar të KGJK-së ka gabime teknike në vendosjen e të dhëna dhe më pas mbledhjen e tyre, prandaj deri tek përfundimi kemi ardhur pas mbledhjes së të dhënave nga tabelat për secilin nivel të gjykatave.

10 [http://www.echr.coe.int/Documents/Convention\\_SQL.pdf](http://www.echr.coe.int/Documents/Convention_SQL.pdf)





## ÇFARË (S)ËSHTË BËRË PËR TË REDUKTUAR NUMRIN E LËNDËVE?

KGjK gjatë vitit 2013 ka miratuar një strategji për reduktimin e lëndëve të vjetra në gjykata.<sup>11</sup> Sipas kësaj strategjie deri në gusht të vitit 2013 kishin mbetur edhe 142 mijë lëndë të përkufizuara si të vjetra duke përfshi edhe 91 mijë lëndë të përmbartimit. Si lëndë të vjetra strategjia e vitit 2013 i konsideron të gjitha lëndët që deri në fund të vitit 2011 kishin mbetur të pa zgjidhura nga gjykatat tona. Strategjia për reduktimin e lëndëve parasheh detyra për KGjK-në dhe menagjmentin e gjykatave. Detyrat sipas strategjisë janë detyra administrative që KGjK dhe gjykatat duhet t'i kryejn gjatë implementimit të strategjisë. Ndër të tjera aty është paraparë që të gjitha lëndët e parashkruar të vendoset me një shabllon të aktvendimit për hedhje poshtë, të vendoset menjëherë për të gjitha lëndët që kanë marrëveshje ose pranim fajsie, të sigurohen praktikantë pa ndonjë kosto për KGjK-në, të bëhet ricaktimi i gjykatësve varësisht nga nevojat që ka gjykata etj. Shumica e detyrave që janë caktuar sipas strategjisë janë përfunduar ose janë në proces të punës, por që rezultatet sipas statistikave tregojnë se përkundër kësaj nuk kemi ndonjë rezultat të kënaqshëm në zbutjen e numrit të lëndëve.

Tutje numrin e lëndëve në gjykata e rritë shumë edhe procedura e kundërvajtjes, apo lëndët në kundërvajtje. Vetëm në vitin 2015 në gjykata kanë qenë në punë 516,947 lëndë të natyrës kundërvajtjeve, ndërsa të pa zgjidhura në fund kanë mbetur 211,087 lëndë, ndryshe nga viti paraprak ku pa zgjidhur kishin mbetur 189,785 lëndë, pra nga statistikave të KGjK-së del se kemi një rritje prej 21,302 lëndësh vetëm në kundërvajtje. Në shtator të 2016 ka hyrë në fuqi Ligji i ri për rregullat e trafikut rrugor<sup>12</sup> me të cilin ligj janë paraparë edhe rregulla të reja dhe gjopa më të rritura për rastet e kundërvajtjeve në trafik. Mirëpo ky ligj në nenin 259 ka paraparë që çdo gjobë që kalon vlerën 60 euro, automatikisht të bëhet lëndë për gjykim nga gjykata<sup>13</sup> e që shumica e neneve të ligjit parasheh gjopa më të larta se 60 euro. Rrjedhimisht

11 STRATEGJIA KOMBËTARE PËR REDUKTIMIN E LËNDËVE TË VJETRA <http://www.gjyqesori-rks.org/sq/kjc/report/list/3>

12 Ligji për rregullat e trafikut publik 05/L-088, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=12822>

13 Neni 259 Gjobatme të holla: Polici i cili e rregullon dhe e mbikëqyr trafikun rrugor, në vendin e shkakimit të kundërvajtjes shqipton gjobë me të holla deri në gjashtëdhjetë (60) euro. Kundërvajtjet më gjobë të parapara mbi këtë shumë procedohen në gjykatën kompetente.

Vetëm në vitin 2015 në gjykata kanë qenë në punë

# 516,947

**lëndë të natyrës kundërvajtjeve**

me hyrjen në fuqi të këtij ligji, gjykatave potencialisht do t'u shtohen akoma më shumë raste nga kundërvajtjet për të gjykuar. Në anën tjetër nëse KGjK nuk merr masa në rritjen e theksuar të numrit të gjykatësve dhe stafit mbështetës atëherë për disa vite numri i lëndëve potencialisht mund të dyfishohet.

Një shqetësim i vazhdueshëm është numri i lëndëve të vjetra në çështjet penale, civile, ekonomike dhe administrative që janë mbetur pa u përfunduar. Deri në fund të vitit 2015 sipas statistikave zyrtare të KGjK-së<sup>14</sup> pa zgjidhur kanë mbetur 63,281 lëndë<sup>15</sup> të këtyre lëmive. Nëse krahasohen statistikave ndër vite, shihet se ka lëndë që datojnë nga viti 1999 e që nuk janë proceduar apo përfunduar nga gjykata.<sup>16</sup> Trendi i lëndëve të pazgjidhura në vitet vijuese vetëm sa është rritur. Kështu në vitin 2000 kanë mbetur pa u përfunduar 26 lëndë, në vitin 2001 -51 lëndë, në 2002 - 79 lëndë ndërsa nga viti 2003 kanë mbetur edhe 132 lëndë pa përfunduar. Në fund të vitit 2015 kishte 20,546 lëndë të pa kryera. Të gjitha këto të dhëna, mund të shihen figurativisht në tabelën më poshtë:

14 KDI përmes kërkesë për qasjen në dokumente publike i është qasur statistikave të KGjK-së.


15 Në total nuk janë përfshirë lëndët nga kundërvajtjet dhe lëndët nga ekzekutimet penale dhe civile.

16 Gjykata Themelore në Prishtinë ka trashëguar 5 lëndë të natyrës civile dhe 2 lëndë të natyrës penale në departamentin e Krimeve të rënda, ndërsa Gjykata Themelore në Mitrovicë ka një lëndë të natyrës penale po në departamentin e krimeve të rënda.




**TRENDI I LËNDËVE  
TË PA ZGJIDHURA  
DERI NË VITIN 2015**

**TOTALI: 63,281**



**LËNDET E PA  
ZGJIDHURA NË  
GJYKATËN THEMELORE  
NË PRISHTINË**

**TOTALI: 35,358**




Numri i lëndëve të pazgjidhura të natyrës penale (pa përfshirë ato për krime të rënda dhe veprat penale për të mitur)


në Gjykatën Themelore të Prishtinës deri në fillim të 2016 në total ishte 11,538. Shih tabelën 3 më poshtë:



**LËNDET PENALE NË  
GJYKATËN  
THEMELORE  
PRISHTINË**



**TOTALI: 11,538**





Bazuar në statistikat e KGjK-së, Gjykata Themelore e Prishtinës, më e madhja në vend, prin për nga numri i lëndëve të pazgjidhura ndër vite. Gjykata Themelore e Prishtinës së bashku me degët e saj në Lipjan, Drenas, Podujevë dhe

Graçanicë kanë një total prej 44,785 lëndësh të pa zgjidhura. Vetëm Gjykata Themelore në Prishtinë pa degët e saj ka numrin rekord prej 35,358 lëndë të cilat janë të pa zgjidhura deri në fund të vitit 2015. Shih tabelën 2 më poshtë:



KGJK në një raportin e saj për performancën e gjykatave në ekzekutimin apo përmbarimin e lëndëve në rastet e hipotekave, falimentimit dhe ato që lidhen me tatimet tregon se gjykatave u është dashur mesatarisht 650 - 1500 ditë për zgjidhjen e një lënde.<sup>17</sup> Ky është ndër raportet e para të bëra publike nga KGJK-ja në lidhje me atë se sa kohë i duhet gjyqësorit të Kosovës për t'u përmbuar pa llogaritur këtu se sa kohë i ju është dashur këtyre lëndëve që të vijnë deri tek vendimi përfundimtar. KGJK asnjëherë nuk ka publikuar analiza se sa kohë merr mesatarisht një lëndë për t'u zgjidh nga gjykatat nga koha kur është dorëzuar e deri në plotfuqishmërinë e vendimit për atë çështje dhe përmbarimin-ekzekutimin e saj. Po ashtu nuk ka ndonjë analizë se sa buxhet shpenzohet në një lëndë deri në përfundimin total të saj apo sa buxhet shpenzohet për secilën fazë nga gjykata. Në anën tjetër nuk kemi ndonjë raport statistikor që tregon se sa qytetarët shpenzojnë gjatë kontesteve civile, administrative, ekonomike apo procedurës penale.

Vetëm Gjykata Themelore në Prishtinë pa degët e saj ka numrin rekord prej


 **35,358**

**lëndë të cilat janë të pa zgjidhura deri në fund të vitit 2015.**

Numri i lëndëve të pazgjidhura të natyrës penale (pa përfshirë ato për krime të rënda dhe veprat penale për të mitur) në Gjykatën Themelore të Prishtinës deri në fillim të 2016 në total ishte

 **11,538**

17 Shih: <http://www.gjyqesori-rks.org/GetDocument/2414>



## PARASHKRIMI SI “MASË” PËR REDUKTIMIN E LËNDËVE

Performanca e dobët e gjyqtarëve por edhe numri i pamjaftueshëm i gjyqtarëve ka bërë që lëndët shpeshherë të mos procedohen dhe të parashkruhen. Sipas raporteve të organizatave të shoqërisë civile del se një numër jo i vogël i lëndëve është parashkruar dhe vazhdon të arrin parashkrimin çdo ditë të vitit. Sipas këtyre hulumtimeve të cilat i ka konsultuar KDI del se shumë lëndë janë parashkruar për shkak të pasivitetit të gjykatësve, pra parashkrim relativ. Tek këto lëndë gjykatësit nuk kanë vepruar në kohë që është paraparë me ligj prandaj edhe janë parashkruar. Në rastet e parashkrimit relativ ndërprerja e parashkrimit është shumë e thjeshtë, pasi që me një veprim shumë të vogël procedural (p.sh. caktimi i seancës dhe dërgimi i ftesave) do të ndërpritej parashkrimi relativ. Në anën tjetër shohim një numër po ashtu jo të vogël të rasteve të parashkrimit absolut, i cili parashkrim, sipas ligjit, duhet të kalojë së paku dyfishin e dënimit më të lartë për veprën e caktuar që të arrihet parashkrimi absolut. Pra në këto dy raste shihet se gjykata nuk ka vepruar konform ligjeve në fuqi, për çka edhe lëndët janë vjetërsuar duke i lënë palët pa e marrë verdiktin final nga gjykata në janë të fajshëm apo të pafajshëm. Sipas raportit të Organizatës Çohu!<sup>18</sup>, nga viti 2000 deri në vitin 2013 janë parashkruar 10,504 lëndë të natyrës penale dhe ekzekutime të dënimeve penale nga të cilat 5226 lëndë kanë parashkrim absolut<sup>19</sup>. Bazuar në një raport më të hershëm të kësaj organizate del se arsyetimet e gjykatësve në rastet të parashkrimit janë: “numri i madh i lëndëve, mungesa e gjykatësve, mos gjetja e të pandehurve as nga gjykata e as nga policia, adresat e gabuara, fshehja e të pandehurve, etj.”<sup>20</sup>

18 Raporti për parashkrimin në Gjykata Themelore faqe 21 [http://cohu.org/repository/docs/Parashkrimi\\_2001-2013\\_cohu\\_735470.pdf](http://cohu.org/repository/docs/Parashkrimi_2001-2013_cohu_735470.pdf)

19 Raporti për parashkrimin në Gjykata Themelore faqe 33 [http://cohu.org/repository/docs/Parashkrimi\\_2001-2013\\_cohu\\_735470.pdf](http://cohu.org/repository/docs/Parashkrimi_2001-2013_cohu_735470.pdf)

20 Raporti për parashkrimin në Gjykata Komunale faqe 22 [http://cohu.org/repository/docs/Parashkrimi\\_final\\_2013\\_84095\\_304261.pdf](http://cohu.org/repository/docs/Parashkrimi_final_2013_84095_304261.pdf)

# RASTET E RAPORTUARA NË KDI

KDI ka funksionalizuar Shërbimin për Këshilla Ligjore për dëshmitarët, viktimat dhe denoncuesit e korrupsionit, ku ka pranuar mjaft raste që kanë lidhje direkte me gjykim në kohë të arsyeshme. Stërzgjatja e trajtimit të këtyre lëndëve, u ka mundësuar zyrtarëve që mund të ndikojnë në përshpe-

jtimin e tyre, që të kërkojnë mito për një proces të tillë. Veprimi korruptiv ka ngjarë edhe kur janë trajtuar me prioritet raste e të afërmeve të ndonjërin nga personeli i gjykatave. Kërkimi i mitos i ka ndodhur dy klientëve të shërbimit tonë, raste e të cilëve janë të shpjeguar më poshtë.

## RASTI NN1

NN1<sup>21</sup> nga komuna e Podujevës menjëherë pas luftës kishte filluar punë si roje sigurie në një nga ndërmarrjet më të mëdha në vend.<sup>22</sup> Pas më shumë se një viti punë, derisa ishte duke shkuar për t'u paraqitur në vend të punës, pëson aksident. Aksidenti shkaktohet nga një punëtor tjetër i ndërmarrjes. Pasi që qëndron një kohë në spital duke marrë trajtimin e duhur, ndërmarrja i ofron pensionim të parakohshëm dhe NN1 pa e ditur saktë se çfarë po i ofrohej pranon. Më vonë e kupton se nuk mund të kthehet në punë dhe për lëndim në vend të punës paditë ndërmarrjen ku kishte punuar, me pretendimin se në vendin e punës i ishte shkaktuar aksidenti me pasojë invaliditetin e pjesshëm. Padia ishte deponuar në gjykatë në vitin 2002. Seancat

kishin filluar të mbahen në vitin 2005, pas seancave të mbajtura NN1 nuk e kishte fituar kontestin, për çka ishte ankuar në vendim. Ankesa kishte arritur të shqyrtohet vetëm në vitin 2008 me çka gjykata e shkallës së dytë e kishte kthyer çështjen në rigjykim. Pas rigjykimit, NN1 kishte fituar kontestin, por tani ishte ankuar në shkallën më të lartë ndërmarrja e paditur. Prapë gjykata e shkallës së dytë e kishte kthyer çështjen në rigjykim dhe gjykata e shkallës së parë kishte vendosur kundër paditësit NN1. Tutje NN1 ka paraqitur ankesë në shkallë të dytë dhe që nga 2014 është duke pritur në marrjen e një vendimi në kontestin e tij. NN1 ka 14 vjet që pret epilog për rastin e tij. Shpenzimet administrative që ka bërë për këto 14 vjet sipas tij janë mbi 10 mijë euro. Shpenzime kanë bërë edhe gjykatat kur kanë mbajtur seanca e kanë vendosur dhe vazhdojnë të bëjnë shpenzime pa përfunduar çështjen me një vendim meritore dhe pa e kthyer çështjen në rigjykim vazhdimisht.

21 NN1 Palë e regjistruar në databazën e Shërbimit për Këshilla Ligjore të KDI-së por që me kërkesë të tij i mbrohet identiteti.

22 KDI mbron identitetin e palëve të përfshira në këtë rast me kërkesë të palës ankuese/raportuesit.



Shpenzimet administrative që ka bërë për këto **14 vjet** sipas tij janë **mbi 10 mijë euro**.



## RASTI NN2

NN2<sup>23</sup> nga Mitrovica ka një rast të ngjashëm të vonesave nëpër nivelet e gjykatave e në mungesën e përmbartimit. Rasti i tij ka të bëjë me moskompensimin e pronës e marrë nga Komuna qysh para luftës së fundit, përkatësisht prona ishte marr në vitin 1996. Meqë nuk i ishte bërë kompensimi adekuat NN2 kishte paraqitur padi para ish Gjykatës Komunale në Mitrovicë që në vitin 1997 ku edhe e kishte fituar kontestin. Pasi që kishte filluar lufta vendimi kishte mbetur i pa përmbartur. Pas luftës NN2 menjëherë interesohet për rastin e tij dhe për vazhdimin e procedurave. Fillimisht NN2 nuk e gjen dosjen e lëndës në gjykatë, dosja e tij kishte humbur diku në arkivat e gjykatës gjatë luftës. NN2 pas shumë përpjekjesh arrin ta gjejë vendimin e gjykatës dhe të gjitha shkresat e lëndës dhe gjykata krijon dosjen e tij. Sapo komuna merr vendimin për përmbartim, e konteston me arsyetimin se nuk është trashëgimtare e komunës së para luftës dhe se nuk ka mjete për kompensim. NN2 përgjigjet në çdo ankesë të komunës dhe çdo vendim gjykate ishte në favor të tij. Lënda duhet të përmbartohet kishte urdhëruar gjykata, mirëpo nuk kishte marrë asnjë veprim në drejtim të përmbartimit.

23 NN2 Palë e regjistruar në databazën e Shërbimit për Këshilla Ligjore të KDI-së por që me kërkesë të tij i mbrohet identiteti.

it, për çka NN2 i lodhur nga stërzgjatja e procedurave dhe pritja e radhës kishte vendosur që të drejtohej tek përmbartuesi privat. Kur komuna kishte parë vendimin e përmbartuesit për përmbartim të aktgjykimit të gjykatës, kishte paraqitur prapë ankesë në gjykatë, fillimisht në atë të shkallës së parë (e cila ju është refuzuar) e më pas edhe në atë të shkallës së dytë. NN2 edhe sot është duke pritur që të vendoset për çështjen e tij nga gjykata e shkallës së dytë. Lënda e tij nuk ka marrë epilog përfundimtar që 17 vite. Ajo është karakterizuar me vonesa të njëpasnjëshme nëpër nivele të ndryshme të gjykatave duke i shkaktuar shpenzime të vazhdueshme NN2 dhe pa i dhënë drejtësi në çështjen e tij. Nëse kalkuloheh humbjet materiale dhe morale të NN2 me mos realizimin e së drejtës së tij janë të shumta. Fillimisht humbja e pronës së tij, nga e cila mund të gjeneronte të ardhura minimale nëse të njëjtën do ta jepte me qira në këto 17 vite ose shitja e saj do të ishte bazë e mjaftueshme për blerjen e një prone tjetër të përafërt. Në anën tjetër humbjet të tjera palës i janë shkaktuar nga pagimi i avokatëve për ndjekjen e rastit që të ekzekutohet, po ashtu edhe vajtje ardhjet në gjykatë për realizim të çështjes, përkushtimi në çështje, dëmi emocional dhe mendor, mungesat në punë, dhe së fundmi edhe dërgimi i lëndës tek përmbartuesi dhe shpenzimet tek ai.

## RASTI NN3

NN3<sup>24</sup> nga komuna e Mitrovicës është rasti i tretë i paraqitur në Shërbimin për këshilla ligjore të KDI-së. NN3 në vitin 2009 kishte paraqitur padi në gjykatë për kontest të punës. Fillimisht rastin e kishte fitu-

24 NN3 Palë e regjistruar në databazën e Shërbimit për Këshilla Ligjore të KDI-së por që me kërkesë të tij i mbrohet identiteti.

ar në shkallë të parë, por e paditura më pas ishte ankuar dhe shkalla e dytë e kishte kthyer çështjen në rigjykim. Pas 4 vitesh gjykata e shkallës së parë kishte vendosur që paditësi nuk kishte të drejtë në pretendimet e tij dhe lënda i ishte refuzuar. Për shkak të mungesës së mjeteve financiare NN3 kishte humbur të gjitha afatet ligjore në paraqitjen e ankesës, për çka edhe e kishte humbur kontestin dhe punën.







## RASTI NN4

NN4<sup>25</sup> është ndryshe nga tre të parët. NN4 nga komuna e Skenderajt në fillim të vitit 2015 ka paraqitur padi në lidhje me kontest pronësor në Gjykatën Themelore të Pejës, dega në Istog. NN4 kishte blerë pas luftës një truall në komunën e Istogut, por për shkak të rrethanave personale nuk e kishte përkthyer tokën në emër të tij. Meqë nuk kishte mundësi që kontratën e shitblerjes për regjistrim ta bënte te Noteri për shkak se transaksionet monetare nuk ishin kryer me bankë, i është dashur që ta padis shitësin në gjykatë. Shitësi sipas NN4 pranon shitblerjen e realizuar pasluftës dhe e pranon bartjen e pronësisë tek NN4. Ky i fundit kishte kërkuar disa herë gjatë 2015 caktimin e seancës duke njoftuar gjykatën se çështja përfundon me marrëveshje në mes palëve dhe është vetëm

25 NN4 Palë e regjistruar në databazën e Shërbimit për Këshilla Ligjore të KDI-së por që me kërkesë të tij i mbrohet identiteti.

një seancë që duhet mbajtur. Gjykata deri në fund të gushtit 2016, gati dy vite nga paraqitja e lëndës, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në zgjidhjen e çështjes. Në Gjykatën Themelore në Pejë Dega në Istog, në çështje civile deri në fund të 2015 kishin mbetur papërfunduar 458 lëndë, nga të cilat më së shumti ato të vitit 2014 dhe 2015.<sup>26</sup> Në këtë rast pala vazhdon të mos mund të marr të gjitha benificionet që i ka toka e tij, kjo pasi që në certifikatën e pronësisë nuk figuron emri i tij. Në rast të ndonjë investimi pala do e ketë të pamundur që ta vendos në hipotekë për garanci tokën të cilën e ka blerë. Kjo do t'i pamundësonte marrjen e mjeteve financiare nga institucioni financiar dhe rrjedhimisht do t'i pamundësonte realizimin e investimit.

26 KDI përmes kërkesë për qasjen në dokumente publike i është qasur statistikave të KGJK-së.



Në Gjykatën Themelore në Pejë Dega në Istog, në çështje civile deri në fund të 2015 kishin mbetur papërfunduar **458 lëndë**, nga të cilat më së shumti ato të vitit **2014 dhe 2015**. Në këtë rast Rasti NN4 vazhdon të mos mund të marr të gjitha benificionet që i ka toka e tij, kjo pasi që në certifikatën e pronësisë nuk figuron emri i tij. Në rast të ndonjë investimi pala do e ketë të pamundur që ta vendos në hipotekë për garanci tokën të cilën e ka blerë. Kjo do t'i pamundësonte marrjen e mjeteve financiare nga institucioni financiar dhe rrjedhimisht do t'i pamundësonte realizimin e investimit.



## KU QËNDROJNË KËTO RASTE SOT?

Shërbimi për Këshilla Ligjore pranë KDI-së ka pranuar dhe ka dhënë këshilla ligjore falas për këto raste ku është shkelur çdo parim i drejtësisë për gjykim në kohë të arsyeshme. Të katër palët janë paraqitur përmes linjës pa pagesë 0800 77 7 77 dhe kanë kërkuar ndihmën ligjore për rastet e tyre. Në dy rastet e para dhe në atë të fundit Shërbimi për Këshilla Ligjore i KDI-së është duke punuar dhe mbanë kontakt të vazhdueshëm me palët në lidhje me veprimet e gjykatës apo institucioneve tjera. Ndërsa në rastin e tretë pasi që KDI ka kërkuar qasje në dosjen e NN3 në gjykatë ka gjetur se NN3 nuk ka asnjë mundësi që ta rikthejë afatin e humbur në paraqitjen e ankesës. Shërbimi për Këshilla Ligjore i KDI-së vazhdon punën e vet në ndihmën e raportuesve, denoncuesve dhe dëshmitarëve të korrupsionit të cilët paraqiten në linjën pa pagesë apo paraqiten përmes formave të tjera pranë KDI-së.

## GJETJET KRYESORE

Vonesat në trajtimin e rasteve apo mos dhënia e drejtësisë në kohë të arsyeshme nga gjykatat tona mbetet aktuale. Nëse një palë, qoftë në procedurë civile, penale, administrative apo ekonomike nuk e merr drejtësinë në kohë të arsyeshme atëherë qytetarët nuk kanë rrugëdalje tjera përpos se t'i drejtohen mënyrave të tjera zgjidhjes së çështjeve të tyre. Në rastet e paraqitura më sipër kemi të bëjmë me procedurë civile dhe të përmbarimit, e që palët presin me vite të tëra që vendimet e tyre të jenë të plotfuqishme por edhe të ekzekutohen. Përkundër gjithë investimeve që janë bërë në sistemin e drejtësisë, gjykatat vazhdojnë që palët t'i lënë të presin me vite të tëra në kryerjen e lëndëve.

Kostoja ekonomike materiale që ju shkaktohet palëve por edhe vet shtetit nga vazhdimi i pa fund i gjykimeve për çështjen e njëjtë është e gjetur tjetër jo më pak e rëndësishme. Palët në këto raste dalin dy herë të dëmtuara, njëherë si taksapagues pastaj edhe si palë në procedurë. Bazuar në tarifën e Odës së Avokatëve<sup>27</sup>, çdo veprim procedural nga avokati i palës ka një kosto të caktuar, e kur shtohen këtu edhe kostot e tjera si ato të udhëtimit, lënies së punës, kosto e kohës së humbur etj. shihet se pala humb shumë nga mos efikasiteti dhe mos gjykimi në kohë të arsyeshme.

Mungesa kronike e gjykatësve dhe stafit mbështetës për gjykatës është faktor tjetër kontribues i vonesave në drejtësi. Rritja e buxhetit për gjyqësinë do të përkthehej automatikisht edhe në rritje të numrit të gjykatësve dhe stafit mbështetës. Kjo rritje në fakt do të ulte shpenzimet tjera që gjykata i ka në mbajtjen dhe menaxhimin e lëndës si dhe do të rriste në mënyrë të theksuar efikasitetin e gjykatës në kryerjen e lëndëve. Po ashtu do të ulte në mënyrë të theksuar shpenzimet procedurale që palët ngarkohen si dhe shpenzimet e avokatit.

<sup>27</sup> [http://oak-ks.org/repository/docs/Tarifa\\_e\\_Avok\\_e\\_apovuar\\_ne\\_Ku-vendin\\_e\\_OAK\\_me\\_dt.\\_20.12.2014\\_812521.pdf](http://oak-ks.org/repository/docs/Tarifa_e_Avok_e_apovuar_ne_Ku-vendin_e_OAK_me_dt._20.12.2014_812521.pdf)

# REKOMANDIME



KGjK duhet të krijojë një sistem funksional të caktimit të rasteve dhe atë duke u bazuar në një numër faktorësh: rëndësia e rastit, vjetërsia, vëllimi i punës dhe konfliktet potenciale të interesit.



KGjK duhet ta rrisë llogaridhënien dhe të jetë më transparente duke përditësuar ueb faqen e saj dhe të gjykatave, duke bërë publike aktgjykimet dhe aktvendimet, duke njoftuar përmes ueb faqes për seancat e caktuara dhe duke publikuar raporte statistikore më të detajuara për lëmi më specifike.



KGjK duhet të përmirësojë sistemin funksional të menaxhimit të lëndëve, raportimit dhe qasjes në statistika, rrjedhimisht KGjK duhet të jetë më transparente në ofrimin e statistikave për publikun.



KGjK duhet t'i kushtojë rëndësi vlerësimit të performancës së secilit gjykatës dhe punëtor ndihmës të gjykatës.



KGjK duhet të përfundojë sa më shpejtë rekrutimin e gjykatësve për të gjitha nivelet e gjykatave në Kosovë, e në veçanti për Gjykatën Themelore në Prishtinë, si gjykata më e madhe në vend me më së shumti departamente.



KGjK duhet të vazhdojë me arsimimin ligjor të gjykatësve, në ngritjen e kapaciteteve të tyre si dhe profilizimin e tyre sipas natyrave të rastit.



KGjK duhet sa më shpejtë të hap konkurs dhe të pranoj sa më shumë këshilltar ligjor, zyrtar ligjor, bashkëpunëtor profesional dhe praktikantë. Këshilltarët ligjor, bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor të paguhen 70% e lartësisë së pagës së Gjykatësit, varësisht nga niveli që ata punojnë, ndërsa praktikantët të paguhen 30% të pagës së bashkëpunëtorit profesional.

# THIRR

**0800  
77 777**

# RAPORTO KORRUPSIONIN

**KORRUPSIONI  
PAMUNDËSOHET  
KUR RAPORTOHET**

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Me përkrahjen e:



Stabilitätspakt für Südosteuropa  
Gefördert durch Deutschland  
Stability Pact for South Eastern Europe  
Sponsored by Germany

ISBN 978-9951-8927-8-0



9 789951 892780

